



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:276873  
Datë: 03.02.2025  
Numri i dokumentit: 06795519

C.nr.2648/21

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.B. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson avokatura “MBN” Shpk. me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.....”, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksident komunikacioni, vlera e kontestit 13,506.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë 03.02.2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.B. nga Prizreni dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “E.....” që paditëses në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, t’ia paguaj shumën e mjeteve si në vijim:

**a) Dëmin jo material**

-në emër të dhimbjeve fizike shumën prej..... 4,000.00 euro

-në emër të frikës së përjetuar shumën prej ..... 2,000.00 euro

-në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumën prej..... 3,000.00 euro

Shuma të cilën është e detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë që të ia paguaj paditëses, në emër të dëmit jo material është në shumën e përgjithshme prej 9.000.00 (nëntë mijë) euro, me kamata ligjore prej 12%, duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (03.02.2025), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm

**b) Dëmin material**

-në emër të ndihmës së personit të tretë shumën prej.....300.00 euro

-në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej.....300.00 euro

-në emer të shpenzimeve të mjekimit shumë prej..... 6.00 euro

Shuma të cilën është e detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve “E.....” me seli në Prishtinë që të ia paguaj paditëses, në emer të dëmit material është shuma e përgjithshme prej 606.00 (gjashtëqind e gjashtë) euro, me kamatë ligjore prej 12%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 09.12.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**II. REFUZHET** si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, mbi shumat e gjykuara në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë: për frikë shumë prej 2,000.00 euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 1,000.00 euro, për ndihmën e personit të tretë shumë prej 200.00 euro dhe për ushqim të përforcuar shumë prej 200.00 euro.

**III. REFUZHET** në tërësi pjesa e kërkesëpadisë së paditëses A.B. nga Prizreni, në emer të rehabilitimit fizioterapeutik në shumë e kërkuar prej 500.00 euro, **si e pa bazuar.**

**IV. DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “E.....” që në emer të shpenzimeve procedurale t’ia paguajë paditëses shumë prej 1,397.80 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

### *Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Paditësja A.B. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj avokatura “MBN” Shpk me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate me datë 09.12.2021, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.....”, me objekt kontesti kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksident komunikacioni, me vlerë të kontestit 4,900.00 euro. Në referatin e padisë i autorizuari i paditësit ka theksuar se me datën 05.11.2021, rreth orës 09:30, në Prizren Rr. “Ekrem Rexha”, është shkaktuar fatkeqësi komunikacioni nga vetura “A” e tipit “VW Caddy” me targa ..... të cilin e drejtonte O.H. dhe këmbësore “B” A.B. me ç’rast lëndime trupore pëson e dëmtura A.B. Më tej ka theksuar se deri të aksidenti i komunikacionit ka ardhur kur shoferi ishte duke e drejtuar automjetin “EV Caddy” në rrugën “Ekrem Rexha” në drejtim të rrugës “Willian Voker” dhe pasi kalon pompën e derivateve “Hib Petrol” dhe përderisa ishte duke qarkulluar në shiritin e majtë të komunikacionit, pasi që rruga ishte me dy shirita për njërin drejtim dhe vozitësi nuk e kishte përshtatur shpejtësinë e automjetit, me këtë rast kur e vëren këmbësoren që ishte duke kaluar rrugën nga ana e djathtë e rrugës, vozitësi tenton t’i shmanget aksidentit duke kaluar nga ana e majtë e rrugës por përsëri vjen deri te goditja e këmbësore me këndin e përparëm të anën së djathtë të automjetit me ç’rast lëndime trupore pëson paditësja. Shkaktari i aksidentit ka poseduar policë valide të sigurimit tek K.S. E..... Si pasojë e lëndimeve të pësuar në këtë aksident dhe procedurave tjera për rehabilitim pas aksidentit paditësja përveç që ka pësuar dhimbje fizike të të gjitha intensiteteve, shëmtim, zvogëlim të përgjithshëm të

aktivitetit jetësor, frikë të intensitetit të lartë dhe të ulët, ka pasur nevojë për përkujdesje të përsosur të tretë, për ushqim të përfunduar, ka pasur shpenzime të mjekimit si ato për terapi fizikale gjithashtu edhe për shpenzime tjera në barna dhe medikamente mjekësore, andaj i ka propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të provave të aprovohet si e bazuar padia e paditëses.

Me parashtrësën e datës 09.08.2024, e ka bërë precizimin e padisë ashtu që ka kërkuar nga e paditura që paditëses në emër të dëmit material dhe jo material t'ia kompensoj shumën prej 13,506.00 euro.

I autorizuar i paditëses av. N.S. nga avokatura "MBN" Shpk me seli në Prishtinë edhe përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbësin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe se nuk kanë vërejtje që baza juridike të ndahet në proporcion prej 70% të përgjegjësisë që i takon të paditurës dhe 30% paditëses, e gjithë kjo e pranuar edhe nga e paditura. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbësin pranë të gjitha deklaramëve në këtë procedurë, sa i përket bazës juridike të njëjtën e kanë sqaruar në seancën fillestare, ndërsa sa i përket lartësisë me anë të ekspertizës mjekësore është vërtetuar se paditësja ka lëndime të rënda trupore. Sa i përket kamatës ka kërkuar nga gjykata që ta pranoj si në precizimin e dorëzuar, respektivisht sipas mendimit juridik të dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës e datës 02.12.2020. Kompania asnjëherë nuk ka dhënë ofertë për paditësen, me çka është shkelur neni 26 pika 1 dhe 2 i LSDA-së, po ashtu e njëjta asnjëherë nuk e ka bërë pagesën për pjesën jokontestuese e të njëjtën nuk e bënë as në këtë seancë e me ç'rast shkelet përsëri neni 26 pika 4 i LSDA-së. Meqë i ka shkelur të gjitha afatet e paditura kërkojnë nga gjykata që të aprovohet kamata prej 12%. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar dhe atë për padi shumën prej 208.00 euro, për 2 seanca (270.40 euro x 2) shumën prej 540.80 euro, për precizimin e padisë shumën prej 208.00 euro, për ekspertizat mjekësore shumën prej 400.00 euro dhe për taksë gjyqësore 41.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 1,397.80 euro.

Në përgjigjen në padi e paditura ka theksuar se e kontestojnë pjesërisht bazën juridike të kërkesëpadisë po ashtu e kontestojnë edhe për nga lartësia e saj. Më tej ka theksuar se bazuar në raportin e aksidentit të policisë e paditura konsideron që përgjegjësi në shkaktimin e aksidentit ka edhe paditësja, për faktin se e njëjta ka kaluar rrugën pa kujdes dhe jashtë vendkalimit për këmbësorë, pra e njëjta ka paraqitur pengesë për pjesëmarrësit në trafik. Në fund ka theksuar e paditura e ka trajtuar kërkesën për dëmshpërblim brenda afateve ligjore dhe paditëses i ka ofruar shumën për marrëveshje 1,379.00 euro.

I autorizuar i të paditurës F.H. edhe përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbësin në tërësi pranë përgjigjes në padi, ku për të paditurën ka qenë pjesërisht kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, edhe ne pajtohemi me të autorizuarin e paditëses për ndarjen e përgjegjësisë në kuptimin e shkaktimit të aksidentit nga i siguruari i jonë në shkallën prej 70% të përgjegjësisë dhe 30% nga paditësja. Sa i përket precizimit të kërkesëpadisë të njëjtën e kundërshton sa i përket lartësisë së saj. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbësin në tërësi pranë përgjigjes në padi, të gjitha deklaramëve nga seancat e kaluara dhe në këtë seancë, pas administrimit të provave i propozon gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj pjesërisht si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

### ***Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar***

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar provat si në vijim: ekspertizën e ortopedisë dhe psikiatrisë (e punuar bashkarisht nga të dy ekspertët) nga eksperti i ortopedisë M.H. dhe eksperti i psikiatrisë Sh.H. e 07.07.2024, raportin e aksidentit me numër 2021-GR-863, i datës 05.11.2021, raportin mjekësor nga Qendra emergjente pranë Spitalit Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren me nr. të protokollit 259227 i datës 05.11.2021, fletëdaljen me nr. 13396, e datës 05.11.2021, raportin e Radiagnostik Center, e datës 08.11.2021, raportin me nr. 1647, I datës 11.11.2021, raportin me nr. 164, I datës 11.11.2021, raportin e datës 15.11.2021, raportin nga Spinal Center me nr. 045856111, të datës 13.11.2021, raportin me nr. 5811, i datës 11.11.2021, dy fletëpagesa me nr. 12359 dhe 11941, të paguara nga 3 euro, dy kupona fiskal në vlerë prej 22.50 euro.

Gjykata pas vlerësimit të theksimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është **pjesërisht e bazuar**.

Nga leximi i ekspertizës së ortopedisë dhe të psikiatrisë e përpiluar bashkarisht nga ekspertët M.H. dhe Sh.H. e datës 07.07.2024, e cila është bërë duke u bazuar në ekzaminimin e drejtpërdrejtë të paditëses dhe dokumentacionin mjekësor të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja A.B. si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar tronditje trunore, ndrydhje koke, ndrydhje qafe, gjakëmbledhje në anën e djathtë të ballit, këto lëndime kategorizohen si lëndim i rëndë trupor, të cilat lëndime kanë shkaktuar dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të rëndë disa sekonda deri në humbjen e vetëdijes, me intensitet të lartë 2 ditë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate duke marrë parasysh lëndimet e kokës dhe tronditjen trunore), me intensitet të mesëm 25 ditë (kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate), me intensitet të ulët kronike ka edhe sot e kësaj dite posaçërisht gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike si pasojë e aksidentit e dëmtura ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur rreth 1-2 sekonda në momentin kur e ka përceptuar se mund t’i ndodh diçka me fatalitet, frikë sekondare të intensitetit të lartë 4 ditë, nga momenti pas përfundimit të aksidentit kur është këndjellur, kur ka kuptuar se çfarë ka ndodhur me të, i ka ndier lëndimet, vuajtjet nga dhimbjet e lëndimit, në mënyrë rapide kanë filluar ankthi, habia, frikë, dhimbjet fizike dhe vuajtjet shpirtërore deri në përfundim të trajtimit në Qendren Spitalore në Prizren, ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm e cila ka zgjatur 2 muaj, e manifestuar si ndrojtje, frikë, shqetësime të ndryshme aknicioze, pagjumësi, pa vullnet dhe indisponim. Për të gjitha këto kishte pa rahat, pagjumësi, pakënaqësi, frikë dhe drojë dhe shqetësime për shëndetin në të ardhmen dhe pasojat e këtij aksidenti, edhe frikë sekondare të intensitetit të ultë që ka vazhduar edhe për 1 muaj tjetër vijues e manifestuar me frikë, ankth të intensitetit të lehtë herë pas here, problem me gjumë si dhe anashkalim të bisedave apo traumës që ka përjetuar. Ekspertët gjithashtu kanë konstatuar se shëmtim trupor nuk ka, zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor sipas tabelës së BQK është 3%, kreu i parë neni 10 pika 5, kapitulli I, pika 1.2.3.a, ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme 25 ditë për plotësimin e nevojave elementare biologjike siq janë: veshmbathja, ushqimi, higjiena personale, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, lëvizja me mjete ndihmëse ose pa to, pasi këto nevoja nuk ka mundur t’i plotësoj vet si pasojë e paaftësisë të pjesshme e shkaktuar nga lëndimet tripore, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm deri në 35 ditë në kuptim

të përzgjedhjes së ushqimit të pasur me proteina, minerale, vitamin, karbohidrate të nevojshme për ngjytjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit post traumatic dhe rehabilitimi fizik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 20 ditësh.

Nga shiqimi i raportit të aksidentit me numër 2021-GR-863, i datës 05.11.2021, gjykata ka vërtetuar se deri të aksidenti kishte ardhur kur vozitësi ishte duke e drejtuar automjetin “ËV Caddy” me targa ..... në rrugën “Ekrem Rexha” në drejtim të rrugës “Ëillian Voker” dhe pasi kalon pompën e derivateve “Hib Petrol” dhe përderisa ishte duke qarkulluar në shiritin e majtë të komunikacionit, pasi që rruga ishte me nga dy shirita për njërin drejtim dhe vozitësi nuk e kishte përshtatur shpejtësinë e automjetit duke u bazuar kushteve të rrugës dhe rrethanave në komunikacion, me këtë rast kur e vëren këmbësoren që ishte duke kaluar rrugën nga ana e djathtë e rrugës, vozitësi tenton t’i shmanget aksidentit duke kaluar nga ana e majtë e rrugës por përsëri vjen deri te goditja e këmbësores me këndin e përparëm të anën së djathtë të automjetit me ç’rast këmbësorja pëson lëndime dhe në automjet shkaktohen dëme të vogla materiale.

Nga shiqimi raportit mjekësor nga Qendra emergjente pranë Spitalit Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren me nr. të protokollit 259227 i datës 05.11.2021, fletëdaljen me nr. 13396, e datës 05.11.2021, raportin e Radiagnostik Center, e datës 08.11.2021, raportin me nr. 1647, I datës 11.11.2021, raportin me nr. 164, I datës 11.11.2021, raportin e datës 15.11.2021, raportin nga Spinal Center me nr. 045856111, të datës 13.11.2021, raportin me nr. 5811, i datës 11.11.2021, gjykata e ka provuar faktin se paditësja A.B. është trajtuar dhe ekzaminuar, për shkak të lëndimeve të pësuar në aksidentin e komunikacionit.

Nga shiqimi fletëpagesave me nr. 12359 dhe nr. 11941, gjykata ka provuar faktin se paditësja kishte marr trajtim mjekësor si pasojë e lëndimeve të marra gjatë aksidentit të përshkruar dhe sipas fletëpagesës ka paguar nga 3 euro .

Nga leximi i kuponit fiskal, të lëshuar nga Ordinanca Specilistike “Spinal Center”, të datës 13.11.2021, gjykata ka vërtetuar pagesën e bërë nga paditësja për vizitën e neurokirurgut, në shumën prej 15.00 euro.

Nga leximi i kuponit të lëshuar nga barnatore “Guri”, të datës 15.11.2021, gjykata ka vërtetuar pagesën e bërë nga paditësja për blerjen e barnave, në shumën prej 7.50 euro.

### ***Baza ligjore***

Me nenin 136 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-77, është paraparë se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, me nenin 137 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*, ndërsa me nenin 140 të po këtij ligji është paraparë se *“fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*, ndërsa me nenin 159 par.1 është paraparë *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm me faj të një zotëruesi*

zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”.. Po ashtu me nenin 183 par. 1 të LMD-së, është paraparë që “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”. Kurse në Ligjin për Procedurën Kontestimore (LPK) 03/L-006, me nenin 14 është paraparë se “në procedurën kontestimore gjykata më pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”, ndërsa me nenin 323 të po këtij ligji është paraparë “Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lire”. Po ashtu me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se “palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Po ashtu bazuar në nenin 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (Ligji Nr. 04/L-018), parasheh “Kompensimi i dëmit material dhe jomaterial bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve”. Dhe sipas nenit 9, par.1 nenpar.1.1 “Sigurimi nga autopërgjegjësia mbulon: 1.1. dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik” dhe neni 25 par.1 të ligjit të lartë cekur, i cili parasheh se “I dëmtuari ka të drejtë që kërkesën për dëmshpërblim nga baza e sigurimit të autopërgjegjësive t’ia parashtrijë drejtpërdrejt siguruesit përgjegjës. Siguruesi është i detyruar që ditën e pranimit ta regjistrojë kërkesën për dëmshpërblim në librin/evidencën e posaçme të dëmeve sipas radhitjes numerike dhe në afat prej tre (3) ditësh, ta vërtetojë pranimin duke njoftuar palën me referencën e kërkesës së evidentuar.”

### **Vlerësimi përfudimtarë i gjykatës**

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura gjykatës i rezultoi se mes palëve ndërgjyqëse ishte pjeërisht kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë dhe lartësia e saj.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit jo material dhe material ka vendosur sipas shkallës së përgjegjësisë për këto dëme të shkaktuara të përcaktuara sipas dispozitave të nenit të 183 LMD-së, e lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), duke u bazuar në udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 27.02.2023 për caktimin e kritereve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material, si dhe në mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. M.H. ortoped dhe Dr. Sh.H. psikiatër

Bazuar në provat e administruara në këtë procedurë kontestimore, ka rezultuar se deri te aksidenti kishte ardhur kur vozitësi ishte duke e drejtuar automjetin “EV Caddy” me targa ..... në rrugën “Ekrem Rexha” në drejtim të rrugës “Eillian Voker” dhe pasi kalon pompën e derivateve “Hib Petrol” dhe përderisa ishte duke qarkulluar në shiritin e majtë të komunikacionit, pasi që rruga ishte me nga dy shirita për njërin drejtim dhe vozitësi nuk e kishte përshtatur shpejtësinë e automjetit duke u bazuar kushteve të rrugës dhe rrethanave në komunikacion, me këtë rast kur e vëren këmbësoren

që ishte duke kaluar rrugën nga ana e djathtë e rrugës, vozitësi tenton t'i shmangët aksidentit duke kaluar nga ana e majtë e rrugës por përsëri vjen deri te goditja e këmbësore me këndin e përparëm të anën së djathtë të automjetit me ç'rast këmbësorja pëson lëndime dhe në automjet shkaktohen dëme të vogla materiale.

Në lidhje me lartësinë e kërkesave të aprovuara sikurse në shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata konstaton se të njëjtat janë adekuate, e gjithë kjo duke u bazuar në lëndimet e pësuar nga paditësja si pasojë e aksidentit të shkaktuar. Duke u bazuar në ekspertizën e ortopedisë dhe psikiatrisë të përpiluar nga ekspertët Dr. M.H. ortoped dhe Dr. Sh.H. psikiatër, gjykata ka vërtetuar faktin se lëndimet e paditëses janë lëndime të rënda trupore. E dëmtuara në këtë rast paditësja në këtë aksident ka pësuar tronditje trunore, ndrydhje koke, ndrydhje qafe, gjakëmbledhje në anën e djathtë të ballit, këto lëndime kategorizohen si lëndim i rëndë trupor. Nga momenti i aksidentimit e deri në fillimin e mjekimit e aksidentuara ka pësuar dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të rëndë disa sekonda, dhimbje fizike me intensitetit të lartë 2 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 25 ditë, ndërsa dhimbje fizike të intensitetit të ulët ka edhe sot e kësaj dite. Si pasojë e lëndimeve të marra në aksident paditësja në aksidentin e ndodhur kishte përjetuar disa lloje të frikës të cilat janë përshkruar nga ekspertët në ekspertizën e tyre, e që më saktësisht kanë konstatuar se paditësja si pasojë e aksidentit ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur rreth 1-2 sekonda në momentin kur e ka përceptuar se mund t'i ndodh diçka me fatalitet, frikë sekondare të intensitetit të lartë 4 ditë, nga momenti pas përfundimit të aksidentit kur është këndjellur, kur ka kuptuar se çfarë ka ndodhur me të, i ka ndier lëndimet, vuajtjet nga dhimbjet e lëndimit, në mënyrë rapide kanë filluar ankthi, habia, frikë, dhimbjet fizike dhe vuajtjet shpirtërore deri në përfundim të trajtimit në Qendren Spitalore në Prizren, ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm e cila ka zgjatur 2 muaj, e manifestuar si ndrojtje, frikë, shqetësime të ndryshme akncioze, pagjumësi, pavullnet dhe indisponim. Për të gjitha këto kishte pa rahat, pagjumësi, pakënaqësi, frikë dhe drojë dhe shqetësime për shëndetin në të ardhmen dhe pasojat e këtij aksidenti, edhe frikë sekondare të intensitetit të ultë që ka vazhduar edhe për 1 muaj tjetër vijues e manifestuar me frikë, ankth të intensitetit të lehtë herë pas here, problem me gjumë si dhe anashkalim të bisedave apo traumës që ka përjetuar. Ekspertët gjithashtu kanë konstatuar se paditësja shëmtim trupor nuk ka, zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor sipas tabelës së BQK është 3%, ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme 25 ditë për plotësimin e nevojave elementare biologjike siq janë: veshmbathja, ushqimi, higjiena personale, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, lëvizja me mjete ndihmëse ose pa to, pasi këto nevoja nuk ka mundur t'i plotësoj vet si pasojë e paaftësisë të pjesshme e shkaktuar nga lëndimet trupore, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm deri në 35 ditë në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasur me proteina, minerale, vitamin, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit post traumatic dhe rehabilitimi fizik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 20 ditësh. Të gjitha këto lëndime të përshkuara detajisht në ekspertizën e ekspertëve të cilës gjykata ia fali besimin e plotë, pasi që gjykata gjeti se ekspertiza është përpiluar dhe e argumentuar në mënyrë të qartë nga ana e ekspertëve dhe bazuar në shkresat e lëndës. Vlen të ceket se për këtë ekspertizë nuk kanë pasur vërejtje e as pyetje nga ana e palëve ndërgjyqëse.

Andaj të gjitha këto e kanë bindur gjykatën që të vendos sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi pika (a) duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, pasi që shumat e aprovuara janë në përputhje të plotë me lëndimet e pësuara nga paditësja.

Lidhur me kërkesën e paditëses që ka të bëjë me detyrimin e palës së paditur që paditëses në emër të ndihmës së personit të tretë t'ia paguaj shumën prej 300.00 euro dhe në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 300.00 euro, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pika (b) duke i aprovuar pjesërisht kërkesat e të njëjtës, pasi që kjo gjykatë i vlerëson si të pranueshme për nga baza, duke marr për bazë kohëzgjatjen e nevojës për përkujdesjen e personit të tretë, si dhe për ushqimin e përforcuar të nevojshëm të konstatuar në ekspertizë mjekësore për paditësen, si dhe nga fakti që praktika gjyqësore i njuh rastet e tilla të kompensimit. Në këtë drejtim, duhet të merret parasysh fakti se për këto forma të dëmit në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo, pasi që paditësja ka pasur nevojë për ndihmën e huaj, ushqim të përforcuar (sikurse në ekspertizë), të njëjtës ligjërisht i takon ky lloj dëmi i kërkuar dhe në shumat e vlerësuara nga ana e gjykatës.

Ekspertët përkatës kanë vlerësuar se lëndimet e paditëses janë lëndime të cilat karakterizohen si lëndime të karakterit të rëndë trupor. Andaj, edhe lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarës-paditëses, satisfaksion që ajo të jetë në gjendje t'i kompensojë të mirat jo materiale dhe materiale nga të cilat është privuar, e kjo duke marr parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve, frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe të gjitha lëndimeve tjera të përshkruara më hollësisht në ekspertizën e ekspertëve përkatës, të cilat i kemi përmendur më lartë, gjykata ka vendosur sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket dëmit material tjetër i cili rrjedh si pasojë e shërimit të paditëses, pas shkaktimit të aksidentit ( vizitave mjekësore etj.), në shumat e cekura sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ato janë të argumentuar me prova konkrete (fletëpagesave), të cilave gjykata ia fali besimin e plotë, andaj dhe këto shpenzime i ka aprovuar si të bazuara, pasi nga fletëpagesat e paraqitura konstatohet fakti se lartësia e të hollave të cilat i ka shpenzuar paditësja gjatë periudhës së mjekimit është në shumën prej 6.00 euro dhe atë duke u bazuar në kërkesën e palës paditëse dhe në fletëpagesat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, Gjykata mbi bazën e vlerësimit të të gjitha kriterëve dhe masave për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material dhe vlerësimit të ekspertizave, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, duke gjykuar vlerën e shpërblimit të dëmit si në pikën I të dispozitivit, të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi duke refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses dhe atë për frikë shumën prej 2,000.00 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën 1,000.00 euro, për ndihmën e personit të tretë shumën prej 200.00 euro dhe për



ushqim të përforcuar shumë prej 200.00 euro, ngase konsideroi se shumat e kërkuara mbi shumat e aprovuara si në pikën I të dispozitivit janë të larta dhe nuk i përgjigjen lëndimeve të cilat i ka pësuar paditësja në aksident dhe të gjitha rrethanave tjera të cilat janë me rëndësi për vlerësimin dhe caktimin e kompensimit. Andaj, gjykata vlerëson se me vlerat të cilat ka aprovuar në emër të dëmit jo material do të arrihej qëllimi i kompensimit të drejtë të dëmit të pësuar me aksidentin në komunikacion. Gjithsesi, gjykata mori për bazë kushtet dhe rrethanat në të cilat është shkaktuar ky aksident, moshën e paditëses si dhe gjendjen ekonomike në Kosovë.

Ndërsa pjesën tjetër të kërkesës në emër të rehabilitimit fizioterapeutik në shumë prej 500.00 euro, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e refuzuar si të pabazuar, për shkak se pala paditëse gjykatës nuk i ofroi asnjë provë materiale (faturë, kupon fiskal etj), që do të vërtetonte pretendimet e saj lidhur me kërkesat në fjalë. Andaj në mungesë të provave përkatëse gjykata është detyruar që këtë pjesë të kërkesëpadisë së paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse në lidhje me ndarjen e përgjegjësisë, por gjeti se këto pretendime janë të pa bazuara, për faktin se asnjëra nga palët ndërgjyqëse gjatë shqyrtimit gjyqësor e deri në fjalën përfundimtare nuk kanë kërkuar ekspertizë të komunikacionit nga e cila do të vërtetohej fakti për ndarjen përgjegjësisë në kuptim të shkaktimit të aksidentit, poashtu gjykata ka pasur parasysh edhe 2 kuponat fiskal të administruara në këtë procedure por për të njëjtat nuk vendosi për shkak se pala paditëse në parashtrësën e precizuar të datës 09.08.2024 nuk i ka kërkuar si shpenzim, andaj duke pasur parasysh faktin se gjykata vendos gjithnjë brenda kufijve të kërkesës që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse neni 2.1 i Ligjit të Procedurës Kontestimore, vendosi si në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi.

Në lidhje me kamatën ligjore që duhet ta paguaj e paditura për shumë e aprovuar për dëmin jo material dhe material, me kamatë prej 12%, krejt kjo duke u bazuar në nenin 26 para. 1, 2, 4 dhe 6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia nr. 04/L-018 e cila ka hyrë në fuqi me datë 30.07.2011, si dhe duke u bazuar në mendimin Juridik të Gjykatës Supreme me nr.265/2020, të datës 02.12.2020, pjesa e dytë pika XII, Gjykata për dëmin material vendosi që kamata fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë datë 09.12.2021, ndërsa kamata për dëmin jo material fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi (datë 03.02.2025) duke u bazuar në mendimin juridik të lartcekur pika XV.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritorë të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedures kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat nenit 449, 452.1 dhe 463 të LPK-së, lidhur me Rregulloren për Tarifat e Odës së Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 208.00 euro, për precizimin e padisë shumë prej 208.00 euro, për përfaqësim në dy seanca gjyqësore nga 270.40 euro (2 x 270.40) shumë prej 540.80 euro, për ekspertizën psikiatrike 200.00 euro dhe për ekspertizën ortopedike 200.00 euro, për taksën gjyqësore 41.00 euro apo gjithsej shumë e përgjithshme prej 1,397.80 euro.

Numri i lëndës: 2021:276873

Datë: 03.02.2025

Numri i dokumentit: 06795519

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2021:276873, 03.02.2025**

**B. Profesional**

**Ali Kosova**

**Gjyqtari,**

**Agron Karatash**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtës, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.